



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0087

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Kimete Gashi - Kryetare, Agon Ramadani-Anëtar dhe Vedat Poterqoi-Anetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar Operatori Ekonomik (OE) N.N.P. “Hysnia”, me seli në Vushtri, si dhe ankesës së e Operatorit Ekonomik N.P.N “Wenda” me seli në Vushhtëri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e rrugëve të rendit të katërt” me numër të prokurimit VU644-22-8608-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Vushtrrisë, me datën 22.05.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohen, si të bazuara ankesat e OE N.N.P. “Hysnia”, me nr. 2023/0087, e datës 14/02/2023, 20/02/2023 dhe N.P.N “Wenda” me nr.102/2023 të dates 20.02.2023, kurse vendimi i AK, Komuna e Vushtrrisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirembajtja e rrugëve te rendit te katërt” me numër të prokurimit VU644-22-8608-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorive Ekonomik N.N.P. “Hysnia” dhe N.P.N “Wenda” me seli në Vushtri.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu

dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 26.01.2023, ka publikuar Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e rrugeve te rendit te katërt” me numër të prokurimit VU644-22-8608-5-2-1, ku është rekomanduar për kontratë OE “Adnan Bislimi B.I”, me seli në Skenderaj.

Me datë 31.01.2023, ankuesi N.N.P. “Hysnia”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK-Komuna e Vushtrrisë, me datë 10.02.2023, eka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 26.01.2023.

Kërkesa për ri shqyrtim e OE ankues N.P.N “Wenda”, me datë 31.01.2023, si vendimi për refuzim të kërkesës për ri shqyrtim nga AK: 10.02.2023.

Me datën 15.02.2023 OE “N.N.P. “Hysnia”nga Vushtrria, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 87/2023, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Po ashtu kundër vendimit të AK-së të datës 26.01.2023 për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar me datën 20.02.2023 ankesë në OSHP ka parashtruar edhe Operatori Ekonomik “N.P.N “Wenda”, me numër të protokollit 102/23

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur kontratë publike kornizë, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës:130 000,00 €

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 18 janar 2023 ka rekomanduar që:

- Aprovohen si të bazuara ankesat e OE N.N.P. “Hysnia” dhe OE N.P.N “Wenda”, me seli në Vushtri,
- Të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së, i dates 26.01.2023, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “N.N.P. “Hysnia”- Vushtrri

Sqarim hyrës:

Autoriteti kontraktues Komuna Vushtrri, ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë-lloji i kontratës punë, kriteri i dhënies së kontratës, Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët të peshuar, vlera e parashikuar e kontratës 130 000,00 euro. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër eliminimit të operatorit ekonomik ankues, përkatësisht kundër propozimit

për dhënie të kontratës.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues N.N.P “Hysnia” -Vushtrri, më tej si parashtruesi i ankesës, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së, për faktin se ka rekomanduar për kontratë OE “Adnan Bislimi” B.I, i cili për çmime dhe kosto e punës substancialisht është më i lartë se çmimet e NNP “Hysnia”. Më tej OE ankues shton se AK me vendimin e tij qëllimisht ka favorizuar OE duke e rekomanduar për dhënie të kontratës me çmimet e ofruara shumë më të larta se ne, duke na diskriminuar ne si OE, në këtë rast parashtruesin e Kërkesës për Rishqyrtim, i cili në tenderin e tij, përveç tenderit të përgjegjshëm, ka ofruar çmime të arsyeshme dhe të besueshme, çmime të cilat janë të afërta me çmimet aktuale të punëve dhe furnizimeve në tregun e punës dhe të furnizimeve në Kosovë, dhe për këtë arsye ne konsiderojmë me të drejtë se jemi trajtuar Jo - Barabartë dhe në mënyrë diskriminuese në raport me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, andaj vlerësojmë se me Vendimin e tij AK ka shkelur Neni 7 -Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Ekspertja shqyrtuese për këtë pretendim ankimor sqaron se përderisa AK gjatë vlerësimit të ofertave ka konsideruar se OE ankues nuk posedon pajisjet teknike të kërkuara konform dosjes së tenderit, nuk ka mundur që të trajtoj tenderin e OE ankues si tender të përgjegjshëm me çmim më të ulët. Sido që të jetë, ekspertja shqyrtuese më poshtë do të jep përgjigje në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues dhe eliminim e tij nga AK, ku AK gjatë vlerësimit të ofertave ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7 dhe 59 të LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës dhe Letrës standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 19.01.2023 sqaron se OE ankues është eliminuar me arsyetimin se:

...se ju nuk i përmbushni kërkesat minimale të kapacitetit teknik dhe /profesional të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe të Njoftimit për kontratës që nënkupton se:

Nuk përmbushni kërkesën nga neni 9.1 lidhur me 9.2 pika 4 nënpika 2 nga se:

Nuk posedoni Bulldozerin min.8 ton;

Ndërsa në vendimin për refuzim të kërkesë për rishqyrtim të datës 09.02.2023 përveç pajisjes 1(Një) Bullduzher për rrafshimin e tereni minimumu 8 ton, ceket se i mungon edhe pajisja 1 (Një) Bager minimum 20-30 ton.

Operatori ekonomik ankues pretendon se posedon këtë makineri dhe ka bashkangjitur dëshminë në platformën elektronike të E-prokurimit, ku përveç pajisjeve tjera, pretendon se ka bashkangjitur edhe pajisjet në fjale ku dëshmohet përmes dokumenteve, siç janë: Kontrata për qiramarrje të mjeteve të punës e dt. 10.09.2022 e lidhur mes: NNP “ Hysnia” si qiramarrës dhe KNPSH “ Papaenburg & Adriani Company” sh.p.k. si qiradhënës i pajisjeve teknike, pastaj DUD-i doganor, si dhe fotoja, ku në mënyrë të qartë vërtetohet posedimi i pajisjes së kontestuar, d.m.th. AK ka kërkuar "bager" (20-30)ton, ne kemi përmbushur këtë kërkesë sepse posedojmë pajisjen në bazë të dudit doganor, ekskavator KOMATSU PC290 NLC-8, Pesha 29ton, AK sipas

nesh ka marr vendim të padrejtë duke konsideruar që makina e emërtuar si ekskavator nuk përmbush kërkesën e tyre që kanë emërtuar (bager).

Ekspertja shqyrtuese sqaron OE ankues me tender ka bashkangjitur dokumentin me titull “Kontratë Qiraje Për Mjete të Punës”, e lidhur ndërmjet N.N.P. “Hysnia” (qiramarrës) dhe K.N.P.SH. “Papenburg&Adriani Company” sh.p.k. (qiradhënës i pajisjeve teknike), për pajisjet si më poshtë:

1. Bullduzher - Komatsu - D65 EXL12, Pesha 20,000(kg)
2. Eskavator - Komatsu - PC 290 NLC-8, Pesha 29,000(kg)
3. Cilinder – Bomag - BĚ213-DH-2, Pesha 14,300 (kg)
4. Grejder - HBM BG 190 TA-, Pesha 18,000(kg)

Për pajisjen me numër rëndor 1 “Bullduzher - Komatsu - D65 EXL12, Pesha 20,000(kg)”, OE ankues ka bashkangjitur dëshminë DUD-in doganor 00126, ku ceket emri i pajisjes “Eskavator i përdorur, marka KOMATSU, typ: D65-EXL 12...”, pesha e pajisjes 20,000 kg. Meqenëse ekspertja shqyrtuese nuk është eksperte teknike me njohuri specifike në fushën e ndërtimit, sqarojmë se kemi hulumtuar në internet me të dhënat “Komatsu type D65-EXL 12” dhe sipas rezultateve të kërkimit në internet, rezulton se kjo pajisje me emrin “Komatsu type D65 EXL 12” është bullduzher. Në lidhje me rezultatin e kërkimit në internet sipas emrit “KOMATSU type D65-EXL 12” shfaqen fotografit si më poshtë:

Përveç fotove të shfaqura me rastin e kërkimit, kemi hapur edhe “linqe” të ndryshme për të verifikuar nëse të dhënat teknike përputhen me fotot e shfaqura sipas kërkimit në internet, dhe rezulton që tipi D65-EXL 12 i prodhuesit KOMATSU është bullduzher. Për informata më të detajuara të të dhënave teknike, paraqesim linkun si më poshtë për këtë pajisje: <https://www.lectura-specs.com/en/model/construction-machinery/bulldozers-komatsu/d65exl-12-18266> . Andaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit të OE ankues se ju mungon “Bager” 20-30 ton sipas kërkesës 9.1&9.2 të FTD 1 (Një) Bager minimum 20-30 ton nuk është prezantuar në “Kontratës me Qira për mjete pune” por në vend të kësaj pajisje është prezantuar “Eskavator - Komatus-PC 290 NLC-8, ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues në dokumentin e bashkangjitur me titull “Kontratë Qiraje Për Mjete të Punës”, e lidhur ndërmjet N.N.P. “Hysnia” (qiramarrës) dhe K.N.P.SH. “Papenburg&Adriani Company” sh.p.k. (qiradhënës i pajisjeve teknike), te numri rëndor 2 ka ofruar pajisjen “Eskavator - Komatsu - PC 290 NLC-8, Peshë 29,000(kg)”, ndërsa pas shqyrtimit të dëshmimeve të kësaj pajisje, ekspertja shqyrtuese sqaron se sipas DUD-it doganor nr.70031965 rezulton që kjo pajisje të jetë “Eskavator” i përdorur, i prodhuesit Komatsu, tipi PC 290 NLC-8, pesha 29300kg.

Ashtu siç është cekur më lartë, ekspertja shqyrtuese e rithekson se nuk është eksperte teknike me njohuri specifike në fushën e ndërtimit, megjithatë sipas hulumtimit në internet rezulton se “bagger” dhe “excavator” janë pajisje të njëjta. Më poshtë do të paraqesim rezultatet e kërkimit në internet me termin “bagger” dhe “excavator”:

Meqenëse rezultatet e kërimit në internet dalin të njëjta për “bagger” dhe “excavator”, ndërsa OE ankues ka ofruar eskavator me peshë 29300kg që është brenda kufizimeve të përcaktuara në dosje të tenderit prej 20 deri 30 ton, atëherë ekspertja shqyrtuese konsideron se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “N.N.P. "Wenda"- Vushtrri

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues N.N.P “Wenda” më tej si parashtruesi i ankesës, pretendon se AK nuk i ka lejuar qasje konform nenit 10 të LPP-së, në anën tjetër AK në vendimin kundër kërkesës për rishqyrtim të datës 09.02.2023 potencon “në rrethana krejtësisht të paqarta vet përfaqësuesi i OE z. Selmani edhe pse prezent në Zyrat e Drejtorisë se Prokurimit nuk ka shprehur interesin ose kërkesën që të realizoj qasjen e kërkuar në dokumentet për çka AK ka qenë e gatshme të ofroj qasje të papenguar dhe në mënyre të qetë” të njëjti theksojnë se dy operatorëve tjerë pjesëmarrës pas kërkesë për qasje kanë realizuar qasjen e kërkuar.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se në bazë të dokumenteve, OE kishte parashtruar kërkesë për qasje në dokumente, meqenëse është e pamundur të dihet nëse AK nuk ka dhënë qasje apo nëse OE ankues nuk ka pasur interesim të shikoj, ekspertja shqyrtuese sqaron se mohimi i qasjes në dokumente ia pamundëson operatoreve ekonomik konkurrues mbledhjen e informatave të nevojshme të cilat mund të përdoren për ushtrimin e të drejtës për ankesë. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 të LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës dhe Letrës standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 19.01.2023 sqaron se OE ankues është eliminuar me arsyetimin se:

..... nuk i përmbushni kërkesat minimale të kapacitetit teknik dhe /profesional të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe të Njoftimit për kontratës që nënkupton se:

nuk përmbushni kërkesën nga neni 9.1 lidhur me 9.2 pika 4 nga se:

nuk posedoni Bulldozerin min.8 ton;

nuk posedoni Bager minimum 20-30 ton.

nuk posedoni Cilindrin ngjeshës të matrialit min 12-16 ton;

Operatori ekonomik ankues pretendon se posedon këto makineri dhe ka bashkangjitur dëshminë në platformën elektronike të E-prokurimit, “Listën e makinerisë, mjeteve dhe pajisjeve “ por pohon se për paisjen Bager minimum 20-30 ton, ka munguar Dudi doganor që dëshmon peshën e pajisjes, ndërsa për dy pajisje tjerat si Bulldozerin min.8 ton; Cilindrin ngjeshës të matrialit min 12-16 ton, potencon në ankesë se i ka prezantuar në listën e makinerisë me nr. rend. 22 Bager (Bullduzher) i përdorur skiper, TM 50, si dhe me nr. rend. 20 Cilinder për ngjeshjen e rrugëve, mirëpo me rastin e ngarkimit të dokumenteve në platformën elektronike e-prokurim, për shkak të vëllimit të punëve dhe ngarkesës ka harrur të ngarkojmë DUD Dganore dhe Marrëveshjen me qira lidhur me këto dy makineri, andaj AK komisioni i vlerësimit është dashur dhe ka qenë i obliguar të kërkojë sqarime për këto pajisje të cilat i kemi në listën e makinerisë të prezantuar me

rastin e ofertimit dhe te sigurohet se ne i posedojmë këto makineri dhe jo te mos na trajtoj barabartë dhe te na diskriminoj duke ne eliminuar pa kërkuar sqarime shtese ashtu siç e obligon neni 59.2 dhe 72 te LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese sqaron OE ankues me tender ka bashkangjitur dokumentin me titull “Listën e makinerisë, mjeteve dhe pajisjeve” por ashtu siç e pohon edhe vet në ankesë i njëjti nuk ka bashkëngjitur Dëshmia e kërkuar dokumentare për këto pajisje siç janë kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 “Lista mbi makinerinë e cili duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur, ndërsa, makineria në dispozicion duhet të dëshmohet me njërën prej këtyre dëshmimeve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata apo marrëveshje mbi qiramarrjen të cilës duhet ti bashkangjitet edhe dokumenti i automjetit me të cilën dëshmohet pronësia në emër të qiradhënësit.”

Ekspertja shqyrtuese sqaron se Operatoret ekonomik të cilët shprehin interes për një aktivitet të prokurimit janë përgjegjës për ngarkimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara në sistemin e prokurimit para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve për të dëshmuar se plotësojnë kërkesat dhe kriteret e përcaktuar në dosjen e tenderit. Megjithatë AK ka mund që të kërkoj sqarime shtesë OE ankues në bazë të nenit 72 të LPP-së, por duke u siguruar që ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues ne ankesën e dorëzuar në OSHP ka bashkangjitur:

“Dudi Doganor Eskavator me guma, tipi dhe pesha EC 23C (bashkangjitur ne këtë KpR)”

“Marrëveshja mbi qiranë dhe dudat doganor për Bullduzherin dhe Cilindrin (bashkangjitur ne këtë KpR)”

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik me dyfishin e vlerës që ne kemi ofertuar ne këtë tender, me tej OE potencon se çmimi i OE te rekomanduar për dhënie te kontratës është mbi tregun dhe shumë i larta duke dëmtuar buxhetin e Komunës dhe Buxhetin e Republikës se Kosovës. AK - ZPP janë te obliguar te respektojnë nenin 1 dhe 2 te LPP-se, si dhe te jene transparente dhe eficiente ashtu siç obligojnë neni 6 dhe 7 te LPP-se, Ekspertja shqyrtuese sqaron se përderisa AK gjatë vlerësimit të ofertave ka konsideruar se OE ankues nuk posedon pajisjet teknike të kërkuara konform dosjes së tenderit, nuk ka mundur që të trajtoj tenderin e OE ankues si tender të përgjegjshëm me çmim më të ulët. Megjithatë oferta e OE të rekomanduar për kontratë është brenda vlerës se parashikuar të kontratë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se ne FDT është kërkuar BAGER, por dallimi mes BAGERI dhe ESKAVATORI nuk ka sepse behet fjale për një makineri te njëjtë vetëm koncepti gjuhësore, krejt kjo mund te argumentohet me një klikim ne Google dhe dëshmohet se behet fjale për te njëjtën makineri sepse Bageri është identik me Eskavator dhe kryen te njëjtin funksion dhe nuk ka dallim tjera përveç se aspekti gjuhësorë. Ekspertja shqyrtuese nuk është eksperte teknike me njohuri specifike në fushën e ndërtimit, megjithatë kemi hulumtuar në internet me termin “bagger” dhe “excavator” ku rezulton se janë pajisje të njëjta dhe kryejnë të njëjtin funksion. Më poshtë do të paraqesim rezultatet e kërkimit në internet me termin “bagger” dhe “excavator”: Kërkimi në internet me termin “Bagger” dhe rezultatet e kërkimit:

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të aprovohen si të bazuara, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Seanca Degjimore-

Paneli shqyrtues vlerësoj se për këtë çështje juridike nuk ka nevojë që të konvokohet seanca degjimore me palë, pasi që nga shkresat e lëndës, raporti i ekspertit dhe deklarimit të palëve, ka prova të mjaftueshme për marrjen e një vendimi përfundimtar, andaj seanca u mbajt konform nenit 24 par 1 i Rregullores së punës së OSHP-së.

Paneli shqyrtuespas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues vendosi që aktiviteti i prokurimit të sipërshënuar të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRISË, KOMUNA E VUSHTRISË**
- **OE - N.N.P. "HYSNIA", N.N.P. Wenda**
- Arkivës së OSHP-së: